



PUNIM MASTER

**NDIKIMI I STRUKTURËS SË TRUPIT DHE STATUSIT
MOTORIKË NË CILËSINË E JETËS SË FËMIJËVE**

Mentori:

Prof. Doc. Dr. Musa Selimi

Kandidati:

Ardonit Xhemajli

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

1.HYRJE	6
1.2 HULUMTIMET E GJERËTANISHME.....	8
2.QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT	11
4. METODAT E HULUMTIMIT	13
4.1. Rrjedha dhe procedurat e hulumtimit.....	13
4.2Mostra e entitetit	13
4.3 Mostra e ndryshoreve.....	13
4.3.2. Mostra e instrumenteve matëse për vlerësimin e aftësive motorike bazike	14
4.3.3. Mostra e instrumenteve matëse për vlerësimin e strukturës së trupi.....	14
4.3.4 Mostra e pyetësorit për vlerësimin e cilësisë së jetës.....	14
4.4 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE MOTORIKE BAZIKE.....	15
4.4.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse për vlerësimin e aftësive funksionale (përbërja e trupit- bija) .	21
4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	26
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	27
5.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E VARIABLAVE MOTORIKE BAZIKE TE NXËNËSET (FEMRAT)	27
5.1.1 Analiza deskriptive e variablave motorike bazike te nxënëset (femrat)	27

5.2 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE	34
5.2.1 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave motorike te nxënësit (femra)	34
5.2.2 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave motorike te nxënësit (meshkuj).....	35
5.2.3 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave të Përbërjes së Trupit (BIJA) - femrat.....	36
5.2.4 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave të Përbërjes së Trupit (BIJA) - meshkujt	37
5.2.5 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave të cilësisë së jetës (femrat)	38
5.2.6 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave të cilësisë së jetës (meshkujt).....	39
5.2 DALLIMET NË REZULTATET E VARIABLAVE MOTORIKE BAZIKE NDËRMJET NXËNËSEVE (Femra- Meshkuj).....	40
.5.3.1 Dallimet në rezultatet e variablave motorike bazike ndërmjet nxënësëve (femra- meshkuj)	40
5.3.2 Dallimet në rezultatet e variablave të përbërjes së trupit (bija) ndërmjet nxënësëve (femra- meshkuj).....	43
5.3.3 Dallimet në rezultatet e variablave të cilësisë së jetës ndërmjet nxënësëve (femra- meshkuj).....	45
6. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	48
7. PËRFUNDIMI	49
8.VLERA TEORIKE DHE PRAKTIKE E PUNIMIT	53
9. LITERATURA	54

ABSTRAKT

Qëllimi themelorë i këtij punimi është që të bëhen dallimet në mes të karakteristikave antropologjike me përbërjen e trupit (BIJA) të nxënësëve (femra- meshkuj) e grump oshave 12 vjeç të SHFMU “ Selami Hallaçi” në Gjilan.

Në mostrën e këtij hulumtimi janë të përfshira gjithsej 100 (50 femra dhe 50 meshkuj) nxënës të cilët i nënshtrohen orës së rregullt të Edukatës Fizike dhe Sportive dy orë në javë.

Në hulumtim janë aplikuar 6 variabla motorike bazike, 3 variabla funksionale (BIJA) dhe pyetsorë për vërtetimin e Cilësisë së jetës së të testuarve.

Për vërtetimin e dallimeve në mes të nxënësvenë variablat motorike bazike, funksionale (BIJA) dhe pyetsorit është përdorur metoda e T- testit. Në bazë të rezultateve të fituara me anë të kësaj metode, janë realizuar ndryshime të vlefshme në disa nga variablat motorike bazike ndërsa në ato funksionale dhe të cilësisë së jetës nuk është fituar ndonjë ndryshim i vlefshëm statistikorë. Janë fituar vlera signifikante në vlerësimin e korelacionit në disa nga variablat motorike dhe funksionale (BIJA), ndërsa në cilësinë e jetës janë fituar në të gjitha variablat e aplikuar.

Sa i përket ndryshimeve vërehet se janë fituar ndryshime të vogla në mesatare aritmetikore në favor të nxënësve (meshkuj).

Të gjitha këto ndryshime të rëndësishme ndërmjet vlerave mesatare në favor të meshkujve vërtetojnë dhe konfirmojnë se nxënësit (meshkuj) janë me aktiv dhe më të shkathët se vajzat e testuara.

Fjalët kyçe: Nxënësit, nxënëset, motorike bazike, funksionale, dallimet.

APSTRACT

1. HYRJE

Jo rrallë herë ndodhë që informacioni për rritjen e fëmijëve në lartësinë dhe masën trupore shumë shpesh shërben për të kuptuar gjendjen shëndetësore të tyre.

Aktiviteti fizik luan një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të një fëmije. Pjesmarrja e tyre në aktivitet fizik është i rëndësishëm për mardhënjet e tij/saj me moshatarët si në aspektin fizik dhe zhvillimit psikik të tyre.

Pasojat e mbipeshes së hershme janë të përhapura në të gjithë botën. Obeziteti mund të ndikojë negativisht në shëndetin aktual të fëmijëve, në arritjen arsimore, në cilësinë e jetës, dhe marrëdhëniet me moshatarët, etj. (OBSH, 2016).

I gjithë lëmshi figurativ dhe fizik i fëmijës është baza e formimit të personalitetit të tij. Hulumtimet e fundit sugjerojnë që 75% e të rriturve sëmurën si pasojë e sëmundjeve kur ata ishin fëmijë, që do të thotë në çdo të katërtin fëmijë, kështu që vetëm 10% e atyre që ndjekin arsimin parashkollor janë absolutisht të shëndetshëm.

Një fëmijë me një nivel të lartë të aftësive motorike është shumë më aktiv fizikisht, dhe pranohet shumë më lehtë nga bashkë moshatarët e tyre. Po ashtu janë ndër të parët që do të pranohen apo do të zgjidhen për lojra apo gara sortive shkollore, për derisa një fëmij që mbetet jashtë mundësisë për të qenë pjesmarrës në këto gara shkollore do të ndjehet i injoruar përherë (Kunz, 2009; Netelenbos, 2005).

Fëmijët e ngathët janë shpesh fëmijë që rrinë ulur dhe shikojnë shokët duke luajtur, dhe kjo është një efekt negativ, jo vetëm për aftësitë motorike të tyre, por ndikon direkt në vetëbesimin e fëmijës, gjendjen shpirtërore të tyre, depresionin, ankthin, mardhënjet me familjen dhe miqë dhe poashtu edhe suksesin në shkollë. Po ashtu nuk duhet të harrojmë se marrja e kalorive po rritet dhe kjo prirje nuk shoqërohet me aktivitet fizikë në mënyrë që këtë kalori të konsumuar të hargjojnë por përkundrazi (Berkey et al., 2000; Boreham & Riddoch, 2001; Epstein & Goldfield, 1999).

Hipokinezia dhe sëmundjet e civilizimit ndikojnë që fëmijët tanë të bëhen si fëmijë në në shoqëritë më të industrializuara, ku shtimi i peshës tek fëmijët është një dukuri e zakonshme (Gopinath et al, 2012; Haug et al., 2009; Szakály, 2008).

Fëmijët e sotshëm rriten në një botë me shumë stimul, por pa shumë lëvizje. Prandaj nuk është për t'u habitur që numri i fëmijëve që janë në rritje diagnostikohet me një deformim kurrizor, obezitet dhe atë në rrezik të sëmundje të ndryshme (diabeti, sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut, dhe sëmundje malinje të caktuara) (OBSH,2000).

Mësuesit e edukatës fizike dhe profesionistët e tjerë në këtë fushë duhet për të strukturuar dhe zbatuar aktivitete të përshtatshme zhvillimore, të përshtatshme për lëvizje, dhe të inkurajoi zhvillimin e aftësive themelore motorike. Edukimi fizik është lënda e cila rregullon statusin social të fëmijëve dhe si i tillë është shumë i rëndësishëm. Strategjia e mirëfillt e promovimit të shëndetit, kërkon edhe ushtrime fizike te fëmijët. Mbajtja e lëndës së Edukatës Fizike dhe sportive në shkolla kontribon në cilësinë e jetës së fëmijëve dhe të rinjëve, veçanërisht në aspektin shëndetësorë.

Mungesa e hulumtimeve shkencore mbi marrëdhëniet në mes aftësive motorik edhe statusit social, cilësia e statusit ushqyes dhe cilësia e jetës që lidhet me shëndetin e fëmijëve, veçanërisht në mesin tonë, është shumë e rëndësishme që të ndalojmë me kohë sëmundjen moderne që sot po e lufton e gjithë bota siq është obeziteti në moshat e herëshme.

1.2 HULUMTIMET E GJERËTANISHME

Përmbajtja dhe struktura e orëve të edukimit fizik duhet të planifikohet në mënyrë që ora të jetë interesante për nxënësit, të jetë stimulues, dinamike dhe që çdo fëmijë të jetë i lumtur të marrë pjesë. Me atë formon një lidhje të duhur me orën e edukatës fizike, aktivitetin fizik dhe kështu krijohen shprehitë shëndetësore, që do të shoqërojnë një fëmijë, adoleshent ose të rritur për pjesën tjetër të jetës së tyre. Mënyra në të cilën përjetohet ushtrimi dhe aktiviteti fizik në fëmijëri ka një ndikim më vonë duke u përfshirë në moshën madhore. Qëndrimet negative të adoptuara në moshë të re mund të transferohen në moshën madhore (Bailey, 2006; Barnett et al., 2009; Cliff et al., 2009; Haugen et al., 2011).

Në një studim nga Losse et al. (1991) fëmijët e testuar që janë gjashtë vjeçarë kishin një problem me koordinimin. Pas 10 vjetësh fëmijët të njejtit fëmijë ende kishin vështirësi në koordinim, sepse nuk morën ndihmën e duhur nga shoqëria dhe prindërit. Kjo paraqet problem nëse merren parasysh marrëdhëniet pozitive midis koordinimit, me aftësitë tjera fizike, dhe aftësi njohëse që ndikojnë drejtpërdrejt në të mësuarit dhe suksesin në shkollë (Castelli, 2007; Ismail, 1967; Taras, 2005).

Njohuritë e shkëlqyeshme të zhvillimit motorikë, me fizik të mirë, gatishmëria për shëndetë të mirë kontribuojnë në një cilësi më të mirë të jetës, por edhe në një gatishmëri që t'i përgjigjet në mënyrë adekuate çdo situatë të papritur në jetën e përditshme (Madic, 2000).

Aftësitë themelore motorike si vrapimi, kërcimi, kapja, hedhja dhe të ngjashme, mund ndikojnë në pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitetin fizik, formën e tyre fizike, statusin ushqyes, si dhe në cilësinë e jetës (Hardy et al. 2010).

Problemi është se aktiviteti fizik i organizuar është falas, mirëpo koha e paktë e fëmijëve, ose prindërve për t'i bartur fëmijët dhe e kanë shumë të vështirë t'i përballojnë asaj. Kjo është arsyeja pse shkollat dhe institucionet parashkollore kanë një rol thelbësor dhe përgjegjësi për t'iu mundësuar fëmijëve gjatë qëndrimit të tyre që ata të marrin impulse adekuate për zhvillimin fizik dhe motorik. Qëllimi i edukimit fizik në shkollën fillore është të jetë i larmishëm dhe sistematik,

aktivitetet motorike, në lidhje me fushat e tjera arsimore, kontribuojnë në zhvillimin integral të personalitetit të fëmijëve, zhvillimi i aftësive motorike, përvetësimi, përmirësimi dhe aplikimi i aftësive motorike, shprehivëdhe njohuri të nevojshme teorike në kushte të përditshme dhe specifike të jetesës dhe punës(Rregullore për kurrikulën për klasat e para dhe të dyta të arsimit fillor i Education, 2013).

Edukimi fizik bazohet në aktivitetin motorik, me të cilin kryejnë detyra individuale të mësimdhënies. Prandaj, është e domosdoshme që mësuesit të jenë adekuat të angazhuar, dhe mbi të gjitha, mendohet vëllimi dhe intensiteti i aktivitetit të tyre motorik. Përveç kësaj zhvillimi i aftësive motorike, aktiviteti fizik ndikon gjithashtu në ruajtjen e peshës së shëndetshme (parandalimi), d.m.th rregullimi i mbipeshes. Transformime pozitive statusi antropologjik i nxënësëve mund të pritët vetëm nëse veprojnë stimujt një organizëm me intensitet dhe kohëzgjatje optimale, dhe nëse përsëritet gjatë një periudhe kohe. Niveli i rekomanduar i aktivitetit fizik të moderuar deri në atë intensiv në klasa të edukimit fizik ai arrin në 50% deri në 80% të kohës së mësimdhënies, domethënë kohëzgjatjen totale të klasës (Szakály, 2008).

Në periudhën (7- 17 vjecare) synohet zhvillim më i theksuar të aftësive motorike për shkak të pjekurisë biologjike e cila ndikon dukshëm në performancën motorike. (Mladineo, 2006)

(A. Kasa, 1996) në eksperimentin e tij me fëmijët e moshës 10-14 vjeç në Tiranë, të të dy gjinive, ka analizuar gjendjen e aftësive të përgjithshme motorike dhe ka bërë krahasimin me moshatarët e tyre nga vendet e tjera .

Gjatë eksperimentit, në bazë të rezultateve, ai ka ardhur në përfundim se fëmijët tanë në shumicën e elementeve janë të të njëjtit nivel me ata të vendeve të tjera, me një ngecje të theksuar në lëvizjet komplekse (pra në testet e koordinimit)

Sipas Medved (1987), ekzistojnë ligje të diferencuara mirë që rregullojnë rritjen e fëmijëve, dhe mund të klasifikohet në tre kategori:

- Intensiteti i rritjes së organeve individuale nuk është i barabartë;
- Rritja nuk është lineare;
- Organet rritin jo vetëm masën e tyre, por edhe strukturën e tyre ndërsa rriten.

Siç thotë i njëjti autor periudhat e rritjes së një fëmije mund të ndahen afërsisht në:

- Faza e parë e rritjes së shpejtë (nga lindja deri në 3 vjet);
- Faza e parë e rritjes së ngadaltë (nga 4 në 11-13 vjet);
- Faza e dytë e rritjes së shpejtë (pubertetit 11-14- dhe 13-16 vjet);
- Faza e dytë e rritjes së ngadaltë (nga 14-16 në 17-19).

Shëndeti i popullatës ndikohet nga shumë faktorë të ndryshëm. Shëndeti i popullatës mund të ndahet në tre grupe kryesore: gjenetikë, faktorë mjedisorë dhe stilet e jetesës (Hernandez & Blazer, 2006).

Cilësia e jetëse lidhur me shëndetin shkon përtej masave të drejtpërdrejta shëndetësore dhe është e përqendruar në pasojat që vijnë, gjendja shëndetësore tregon cilësinë e jetës (njerëz të shëndetshëm, 2020).

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Problemi i hulumtimit ka të bëjë me marrëdhëniet e parametrave të statusimotorik të fëmijëve në shkollë, dhe aspekte të ndryshme të cilësisë së jetëste lidhur me shëndetin e tyre.

Lëndë e hulumtimit janë aftësitë motorike bazike, struktura e trupit (parametrat funksional) dhe cilësia e jetës.

Qëllimi i përgjithshëm i studimit është të ekzaminojë kontributin e faktorëve morfologjikë dhe motorikë në cilësinë e jetës që lidhet direkt me shëndetin e fëmijëve.

Në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të hulumtimit, objektivat kryesore të qëllimit të këtij hulumtimi janë:

- Përcaktimi i lidhmërisë ndërmjet aftësive motorike dhe atyre funksionale;
- Përcaktimi i dallimeve të strukturës së aftësive motorike dhe funksionale në mes të nxënësëve (femra- meshkuj);
- Përcaktimi i dallimeve të strukturës së cilësisë së jetës në mes të nëxënësëve (femra-meshkuj);

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në përputhje me problemin e shtruar dhe objektivat e hulumtimit janë parashtruar hipotezat e mëposhtme:

H1- Presim rezultate statistikisht domethënëse në parametrat motorikë, në strukturën e trupit dhe në cilësinë e jetës;

H2- Presim të fitohen korelacione statistikisht domethënëse ndërmjet parametrave motorik bazik, funksional dhe atyre të cilësisë së jetës;

H1- Nga analiza e T- testit presim që të arrihen dallime të rëndësishme statistikore në mes të në mes të gjinive në variablat motorike bazike, strukturës së trupit dhe cilësisë së jetës.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1. Rrjedha dhe procedurat e hulumtimit

Sipas orientimit kohor ky është hulumtim transversal në të cilin do të aplikohen metodat empirike dhe statistikore dhe si teknikë e hulumtimit është testimi. Mbledhja e të dhënave është ekzekutuar në ambient të mbyllur (palestra sportive), në të cilën fëmijët e mbajnë procesin mësimorë të rregullt. Gjatë rrjedhës së mbledhjes së të dhënave përveq autorit të punimit janë angazhuar edhe pesë (5) profesor të Edukimit fizik që paraprakisht janë trajnuar për procesin e mbledhjes së të dhënave.

4.2 Mostra e entitetit

Mostrën për këtë hulumtim epërbëjnë nxënësit e moshës 12 vjecrë të SHF “ Selami Hallaqi “ në Gjilan. Mostra ka përfshirë 50 meshkuj dhe 50 femra dhe prindërit e tyre me të cilët është realizuar një pyetësorë për prindërit me gjithësej 5 pyetje. Nxënësit janë testuar në sallën e sporteve të shkollës.

4.3 Mostra e ndryshoreve

Gjatë përzgjedhjes së instrumenteve matëse (testet) është marrë parasysh që ato t'i plotësojnë karakteristikat themelore metrike, t' përshtaten moshës dhe kushteve hapësinore. Variablat e përzgjedhura në këtë hulumtim, mbulojnë hipotetikusht aftësitë motorike karakteristikat antropometrike- funksionale dhe cilësinë e jetës (pyetësorë).

4.3.2. Mostra e instrumenteve matëse për vlerësimin e aftësive motorike bazike

1. **MKVGJA** - Kërcim nga vendi së gjati;
2. **MKVL**- Kërcim vendi në lartësi;
3. **MVR20M**- Vrapim 20 m.nga starti i lartë;
4. **MHTMK** - Hedhja e topit medicinal mbi kokë;
5. **MHTM1D** - Hedhja e topit medicinal me një dorë;
6. **MMSHMA**- Mbledhje dhe shtrirje e muskujve abdominal.
- 7.

4.3.3. Mostra e instrumenteve matëse për vlerësimin e strukturës së trupi

1. **ALART**- Lartësia trupore;
2. **APESHA**- Pesha trupore;
3. **BMI**- Indeksi i masës trupore.

4.3.4 Mostra e pyetësorit për vlerësimin e cilësisë së jetës

Cilësia e jetës së të anketuarve është vlerësuar duke përdorur pyetësorin e cilësisë së jetës në lidhje me shëndetin, Kidscreen-27-version për prindërit (Kidscreen Group Europe, 2006; Ravens-Sieberer et al., 2007).

4.4 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE MOTORIKE BAZIKE

4.4.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse e aftësive motorike bazike

1. MKVGJA - Kërcim nga vendi së gjati

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjuhë që mundëson kërcim më të sukseshëm.

Realizimi i detyrës: E testuara kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm. Merret kërcimi më i mirë.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu jepen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



Foto 1.MKVGJA - Kërcim nga vendi së gjati

2. MKVL- Kërcim vendi në lartësi

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit. E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , e testuara kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal,lexohet diferenca në cm.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë ,e testuara kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime).Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Merret kërcimi më i mirë.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu jepen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



Foto 2. MKVL- Kërcim vendi në lartësi

3. MVR20M- Vrapim 20 m.nga starti i lartë

Vlerësimi: është vlerësuar aftësia e shpejtësisë së vrapimit.

Vendi i realizimit: Vrapimi është realizuar në sallë në fushën e volejbollit. Në gjatësinë 20 m, është shënuar vija e startit dhe në fund vija e cakut, të gjata 1m, të trashësisë 5cm. Në skaje të vijës së cakut është vendosur matësi i kohës me kronometër.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara përgaditet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë.

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjali ”tash”, të testuarat me shpejtësi maksimale vrapojnë gjatësinë e shtegut 20 m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënja e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur të testuarat kalojnë me trung vijën e paramenduar në vijën e cakut. Koha matet në saktësi 0.01s.

Udhëzime të të stuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. E testuara udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin dhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



Foto 3. MVR20M- Vrapim 20 m.nga startit i lartë

4. MHTMK - Hedhja e topit medicinal mbi kokë

Instrumentet: topi medicinal i peshës 1 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- Përshkrimi i detyrës:

- Pozita fillestare: E testuara qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar të shtrira lartë mbi kokë.

- Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa më larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 4. MHTMK - Hedhja e topit medicinal mbi kokë

5. MHTM1D - Hedhja e topit medicinal me një dorë.

Instrumentet: topi medicinal i peshës 1 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- Përshkrimi i detyrës:

- Pozita fillestare: I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me një dorë afër qafës.

- Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.




Foto 5. MHTM1D - Hedhja e topit medicinal me një dorë.

6. MMSHMA- Mbledhje dhe shtrirje e muskujve abdominal

Instrumentet: Kronometri me 1/10sek

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara ka pozitë të shtrirë në shpinë me duar në qafë dhe këmbë të thyera të mbështetura nga trainer.

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarës është që brenda 30sek, sa më shpejt që është e mundur, pa ndërprerje ta ngris trupin.

Vlerësimi: Llogaritet numri i ngritjeve të rregullta në kohëzgjatje prej 30 sek.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu ipen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (u tregohet ngadalë, për ngritjet e rregullta dhe ato jo të rregullta). E testuara bënë disa tentime provuese.



Foto 6. MMSHMA- Mbledhje dhe shtrirje e muskujve abdominal

4.4.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse për vlerësimin e aftësive funksionale (përbërja e trupit- bija)

1. ALART- Lartësia trupore- është matë me antropometër sipas Martininit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. Etestuara drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur

vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metalike.



Foto 7. ALART- Lartësia trupore

2. APESHA- Pesha trupore - është matë me peshore transportabile me saktësi deri në 0.1 kg., të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. E testuara, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg dhe pas secilës matje peshorja kthehet ne zero (0).



Foto 8. APESHA- Pesha trupore

3. BMI- Indeksi i masës trupore, (Body Mass Index-BMI), është një metodë e llogaritjes së të ushqyerit. Indeksi i masës trupore llogaritet shumë thjeshtë, dhe bazohet në bazë të të peshës së trupit dhe lartësisë së trupit.

Kjo llogaritet duke përdorur një formulë shumë të thjeshtë:

$\text{Pesha (kg)/lartësia (m}^2\text{)} = \text{IMT ose BMI}$



Foto 9. BMI- Indeksi i masës trupore

4.4.3 Përshkrimi i pyetësit për vlerësimin e cilësisë së jetës

Cilësia e jetës së të anketuarve është vlerësuar duke përdorur pyetësin e cilësisë së jetës në lidhje me shëndetin (shih faqe 59), Kidscreen-27-version për prindërit (Kidscreen Group Europe, 2006; Ravens-Sieberer et al., 2007).

7 pyetje nga pyetësi i cili është plotësuar nga prindërit e të testuarve zbulon dimensionine aktivitetit fizik dhe shëndetësorë dhe harxhimin e energjisë tek fëmijët.

Pyetësi është plotësuar nga prindërit ku edhe kanë shprehë pajtimin me deklaratat e tyre.

4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që hulumtimi shkencortë jepzgjdhjetë kënaqshme, është e nevojshmeqë të përdorenprocedurat e duhura, të drejta dhe komparative dhe që janë të natyrës problemit tëdhënë.

Të dhënat janë përpunuar në atë mënyrë që së pari janë llogaritur parametrat qendror dhe tëshpërndarjes për secilën variabël dhe ate:

- Vlerat minimale dhe maksimale (**R.min-R.maks**),
 - Mesatarja aritmetikore (**Ma**),
 - Devijimi standard (**Ds**) dhe
 - Parametrat e asimetrisë (**SKEW dhe KURT**).
-
- Për vlerësimin e korelacionit të variablave do të përdoret koeficienti i korelacionit të **Pearsonit**.
 - Analiza Diskriminative (t- testi)
 - Përpunimi i rezultateve do të bëhet përmes programit kompjuterik SPSS versioni 23.
 - Rezultatet e fituara do të paraqiten në formë tabelare, grafike dhe me anë të komenteve tekstuale.

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

5.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E VARIABLAVE MOTORIKE BAZIKE TE NXËNËSET (FEMRAT)

5.1.1 Analiza deskriptive e variablave motorike bazike te nxënëset (femrat)

Në tabelën 1, është paraqitur analiza deskriptive e variablave motorike bazike, te nxënëset e SHFMU “ Selami Hallaci” në Gjilan. Mostra ka përfshirë grupin prej 50 nxënëseve të gjinisë femërore të moshës 12 vjeçare. Për të gjitha variablat janë llogaritur vlerat e mëposhtme: vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness dhe Kurtosis).

Tabela 1. Parametrat themelorë statistikorë të variablave motorike baziketënxënëseve të të moshës 12 vjeçare

Analiza deskriptive							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
MKVGJA	50	1.00	1.85	1.398	0.217	.150	-.616
MKVL	50	20.00	23.80	21.782	0.849	.475	.382
MVR20M	50	3.50	5.20	4.375	0.343	.336	.108
MHTMK	50	2.10	3.50	2.718	0.369	.350	-.560
MHTM1D	50	2.60	5.10	3.512	0.580	.909	.060
MMSHMA	50	9.00	26.00	18.697	4.112	-.223	-.296

Normaliteti i shpërndarjes së rezultateve të testuar në bazë të skeëness dhe kurtosis.

Duke analizuar vlerat e skeëness, si dhe duke analizuar parametrat e shpërndarjes normale të rezultateve, mund të shihet se vlerat e skeëness në të gjitha variablat motorike bazike janë rreth zero dhe kjo na tregon për shpërndarjen normale të rezultateve.

Duke analizuar vlerat e kurtosis, mund të themi se shpërndarja e rezultateve të shumicës së variablave antropometrike statistikisht nuk ndryshon nga ajo normale.

Nga kjo kuptojmë se nxënëset 12 vjeçare të SHFMU “ Selami Hallaci” në Gjilan janë mjaftueshëm grup homogjen.

5.1.2 Analiza deskriptive e variablave motorike bazike te nxënësit (meshkuj)

Në tabelën 2, është paraqitur analiza deskriptive e variablave motorike bazike, te nxënësit e SHFMU “ Selami Hallaçi” në Gjilan. Mostra ka përfshirë grupin prej 50 nxënësëve të gjinisë mashkullore të moshës 12 vjeçare.

Tabela 2. Parametrat themelorë statistikorë të variablave motorike baziketë nxënësëve të moshës 12 vjeçare (meshkuj)

Analiza deskriptive							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
MKVGJA	50	1.15	1.91	1.448	0.190	.555	.334
MKVL	50	20.10	29.20	22.455	1.805	2.576	9.215
MVR20M	50	3.72	5.12	4.410	0.380	-.111	-.655
MHTMK	50	2.90	5.50	3.816	0.624	.838	.945
MHTM1D	50	2.60	4.35	3.220	0.446	.747	.507
MMSHMA	50	15.00	28.00	22.000	3.546	-.176	-.453

Edhe në tabelën 2. Është vlerësuar normaliteti i shpërndarjes së rezultateve të testuar në bazë të skeëness dhe kurtosis.

Pas vlerësimit të rezultateve vlerësojmë se vlerat e skeëness në shumicën e variablave të aplikuara janë rreth zero dhe kjo na tregon po ashtu një shpërndarje normale të rezultateve.

Duke analizuar edhe vlerat e kurtosis, mund të themi se shpërndarja e rezultateve të shumicës së variablave antropometrike statistikisht nuk ndryshon nga ajo normale.

Vlerë më e lartë është fituar në variablën kërcim vendi në lartësi (MKVL), Skew= 2.576, Kurt= 9.215. ku nxënësit (meshkuj) nuk kanë treguar shpërndarje normale të rezultateve gjë që është vërejtur edhe në hulumtimet e autorëve të tjerë ku testet e forces eksplozive dinë shpeshherë ti shmangen shpërndarjes normale të rezultateve përherë për shkak të moshës së ndjeshme në të cilën janë nxënësit.

5.1.3 Analiza deskriptive e variablave funksionale (përbërja e trupit) te nxënëset (femrat)

Në tabelën 3, është paraqitur analiza deskriptive e variablave funksionale, te nxënëset e SHFMU “ Selami Hallaçi” në Gjilan. Mostra ka përfshirë grupin prej 50 nxënëseve të gjinisë femërore të moshës 12 vjeçare. Për të gjitha variablat janë llogaritur vlerat e mëposhtme: vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness dhe Kurtosis).

Tabela 3. Parametrat themelorë statistikorë të variablave funksionale (përbërja e trupit) të nxënëseve të moshës 12 vjeçare (femra)

Analiza Deskriptive							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
ALART	50	137.00	163.00	148.273	6.686	.671	.073
APESHA	50	17.10	61.30	39.464	9.349	.594	.094
BMI	50	14.18	26.53	18.248	3.173	.968	.468

Në tabelën 3, gjithashtu janë llogaritur vlerat e mëposhtme: vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness dhe Kurtosis).

Pas vlerësimit të tabelës shohim se të gjithë shembujt (variablat) janë njëtrajtësisht homogjen dhe se vajzat 12 vjeçare të cilat i nënshtrohen tretmanit kineziologjikë vetëm një herë në javë nga dy orë mësimore dhe të cilat përfitojnë shumë në mbajtjen e peshës trupore dhe ruajtjen e BMI- së, janë të trajtuara njëjtë, dhe se kjo moshë është shumë e rëndësishme që të kenë njohuri të shkëlqyeshme të zhvillimit motorik të cilat ndikojnë shumë në arritjen e ngacmimit të pllakave të rritjes dhe të shfrytëzohet aktiviteti në mënyrë që të përfitojnë në aspektin shëndetësorë.

5.1.4 Analiza deskriptive e variablave funksionale (përbërja e trupit) te nxënësit (meshkuj)

Në tabelën 4, është paraqitur analiza deskriptive e variablave funksionale, te nxënësit e SHFMU “ Selami Hallaci” në Gjilan. Mostra ka përfshirë grupin prej 50 nxënësëve të gjinisë mashkullore të moshës 12 vjeçare.

Tabela 4. Parametrat themelorë statistikorë të variablave funksionale (përbërja e trupit)të nxënësëve të moshës 12 vjeçare (meshkuj)

Analiza Deskriptive							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
ALART	50	135.00	161.00	149.318	7.435	-.234	-.613
APESHA	50	27.10	70.00	44.600	11.030	.433	.034
BMI	50	14.18	27.34	19.758	3.907	.598	-.519

Sikurse në tabelën 3, edhe në tabelën 4 janë janë llogaritur vlerat e mëposhtme: vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness dhe Kurtosis).

Pas Vlerësimit verbal të vlerave vërejmë se edhe te meshkujt sikurse te vajzat janë fituar rezultate mjaftueshëm homogjene dhe vlerat e shpërndarjës normale sillen rreth 0.

Edhe për meshkujt vlene shpjegimi logjik sikurse te femrat e kësaj moshe (shih tabelën 3), gjë që këta nxënës janë të klasëve të përbashkëta dhe se tretmani kineziologjik është po ashtu i njejtë nga ana e arsimit të Ed. Fizik të tyre.

5.1.5 Analiza deskriptive e cilësisë së jetës te nxënëset (femrat)

Në tabelën 5, është paraqitur analiza deskriptive e pyetësorit të aplikuar, te nxënëset e SHFMU “ Selami Hallaçi” në Gjilan. Mostra ka përfshirë grupin prej 50 nxënësëve të gjinisë femërore të moshës 12 vjeçare.

Tabela 5. Parametrat themelorë statistikorë të cilësisë së jetës të nxënësëve të moshës 12 vjeçare (femra)

Descriptive Statistics							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
Si e vlerësoni shëndetin e fëmijës tuaj	50	1.00	2.00	1.4444	.50637	.237	-2.106
A është fëmija juaj fizikisht aktiv	50	3.00	5.00	3.8148	.73574	.312	-1.017
A vrapon gjatë ditës fëmija juaj	50	1.00	5.00	3.1481	.94883	-.024	.040
A ndjehet me energji fëmija juaj	50	2.00	5.00	3.8148	.83376	-.486	.052
A ndihet fëmija juaj sikur po e shijon jetën	50	2.00	5.00	3.9259	1.07152	-.654	-.760
Fëmija juaj a shpenzon kohë me miqt	50	2.00	5.00	3.7037	.99285	.148	-1.264
A ndjehet i argëtuar me miqt e tij	50	2.00	4.00	3.2963	.82345	-.623	-1.227

Në tabelën 5 janë sikurse në tabelat tjera, janë llogaritur vlerat e mëposhtme: vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness dhe Kurtosis).

Në përgjigjën e pyetjës së parë prindërit kanë vlerësuar në mes të përgjigjës së parë dhe të dytë, që do të thotë perfekt dhe shumë mirë, gjëqë edhe vlera e skëness nuk tregon shmangje nga

distribucioni normal. Sikurse në pyetjen e parë edhe në pyetjet tjera janë fituar vlera me shpërndarje normale dhe se grupi i vajzave tregohet në këtë rast si grup mjaftueshëm homogjen.

Prindërit e tyre kanë vlerësuar shëndet të mirë të vajzave të tyre dhe se kjo gjendje është e pëlqyeshme, pasi që gjendja shëndetësore e tyre është e mirë dhe si e tillë tregon se cilësia e jetës te vajzat 12 vjecare të SHFMU është e mirë.

5.1.6 Analiza deskriptive e cilësisë së jetës te nxënësit (meshkuj)

Tabela 6. Parametrat themelorë statistikorë të cilësisë së jetës të nxënësëve të moshës 12 vjeçare (meshkuj)

Analiza Deskriptive							
	N	Minimum	Maximum	Mean	DS	Skewness	Kurtosis
Si e vlerësoni shëndetin e fëmijës tuaj	50	1.00	3.00	1.579	0.607	.498	-.502
A është fëmija juaj fizikisht aktiv	50	2.00	5.00	3.737	0.991	-.172	-.942
A vrapon gjatë ditës fëmija juaj	50	1.00	5.00	3.368	1.116	-.301	-.357
A ndjehet me energji fëmija juaj	50	3.00	5.00	4.263	0.653	-.314	-.506
A ndihet fëmija juaj sikur po e shijon jetën	50	2.00	5.00	3.737	0.872	-.548	.061
Fëmija juaj a shpenzon kohë me miqt	50	3.00	5.00	4.053	0.848	-.107	-1.623
A ndjehet i argëtuar me miqt e tij	50	2.00	4.00	3.526	0.772	-1.310	.171

Në tabelën 6, po ashtu është vlerësuar cilësia e jetës te nxënësit (meshkuj) të SHFMU “ Selami Hallaci” dhe se sikurse te vajzat edhe te meshkujt shohim një grup mjaft homogjen pasi që vlerat e skeëness sillen rreth 0, si e tillë vërejmë se nuk është fituar shmangje nga distribucioni normal i rezultateve. Është e rëndësisë së lart të themi se në pyetjen e fundit se (A ndjehet fëmija juaj i argëtuar me miqt e tij?) vërejmë se është fituar shmangie e theksuar pasi që prindërit konsiderojnë se fëmija i tyre nuk ndjehet mjaftueshëm i argëtuar nga miqt e tyre.

5.2 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE

5.2.1 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet variablave motorike te nxënëset (femra)

Tabela 7. Koeficientët e korelacionit të variablave motorike bazike te nxënëset (femra)

Korelacionet						
	MKVGJA	MKVL	MVR20M	MHTMK	MHTM1D	MMSHMA
MKVGJA	1					
MKVL	.289	1				
MVR20M	-.386*	-.085	1			
MHTMK	.295	.360*	-.140	1		
MHTM1D	.357*	.171	-.081	.475**	1	
MMSHMA	.651**	.315	-.462**	.190	.332	1
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).						
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).						

Koeficientët e korelacioneve ndërmjet variablave motorike baziketënxënëseve (femra) janë paraqitur në tabelën me numër 5. Mostra e të testuarave karakterizohet nga ndërlidhje e rëndësishme në mes kërcim vendi gjatësi (MKVGJA), me vrapim 20 metra (MVR20M), hedhje e topit medicinal me një dorë (MHTM1D) dhe mbledhje dhe shtrirje e muskujve abdominal (MMSHMA) ku koeficientët e korelacioneve janë relativisht të lartë (përkatësisht -.386, .357, .651).

Variabla kërcim nga vendi në lartësi (MKVL) ka fituar ndërlidhje korelative me variablën hedhje e topit medicinal mbi kokë (përkatësisht: .360).

Variabla e shpejtësisë vrapim 20 metra (MVR20M) ka fituar ndërlidhje korelative me variablën mbledhje dhe shtrirje e muskujve abdominal (MMSHMA) përkatësisht: -.462.

Variabla hedhje e topit medicinal mbi kokë (MHTMK) ka fituar ndërlidhje korelative më variablën hedhje e topit medicinal me një dorë (MHTM1D) përkatësisht : .475.

Variabla hedhje e topit medicinal me një dorë (MHTM1D) ka fituar ndërlidhje korelative me kërcim vendi në gjatësi (MKVGJ) dhe hedhje e topit medicinal mbi kokë (MHTMK) përkatësisht: .357, .475.

Variabla e muskujve të forcës së barkut (MMSHMA) ka fituar ndërlidhje korelative më variablën e kërcim vendi së gjati (MKVGJA) dhe vrapim 20 metra (MVR20M).

